


THIRRJE PËR APLIKIM

PËR PROGRAMIN E ASISTENCËS PËR PRODHUESIT E PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT

Linja buxhetore: EuropeAid/138567/DH/SER/XK



INFORMATATË PËRGJITHSHME

Projekti "Mbështetje për Lëvizjen e Lirë të Mallrave" (FMG), i financuar nga Bashkimi Evropian, fton kompanitë kosovare të aplikojnë në **Programin e Asistencës për Prodhuesit e Produkteve të Ndërtimit**. Programi do të përkrah prodhuesit që të përmirësojnë produktet si dhe procedurat e prodhimit në mënyrë që të plotësohen kërkesat për marrjen e shënjimit të konformitetit në produktet e tyre në përputhje me Ligjin për Produktet e Ndërtimit Nr.06/L-033. Programi ofron gjithsej 40 ditë asistencë teknike dhe deri në 10 000 EUR për kostot e testimit të produkteve.

Ky aktivitet është vazhdimësi e përkrahjes për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë pas miratimit të Ligjit për Produktet e Ndërtimit në vitin 2018.

AFATET KOHORE

Detajet e programit do të prezantohen me datën **26 shkurt 2020** në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Afati i fundit për aplikim është **16 mars 2020**.

Programi i Asistencës për Prodhuesit e Produkteve të Ndërtimit do të zhvillohet gjatë vitit 2020.

Për informata të detajuara në lidhje me paraqitjen e aplikacionit dhe kushtet e pjesëmarrjes, lexoni dokumentin udhëzues në:

- Faqen e internetit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë:
<https://mti.rks-gov.net/page.aspx?id=1,107> si dhe në
- Faqen e projektit në Facebook:
<https://www.facebook.com/FreeMovementofGoodsKosovo>